



BULETIN

BASHKIA ELBASAN



NUMËR 2 - SHTATOR 2022

KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE, NË BASHKINË ELBASAN

T'I PËRGGJIGJEMI SFIDAVE TË SIGURISË DHE MBROJTJES SI NJË SHQETËSIM PARËSOR

BULETIN INFORMATIV I KËSHILLIT VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE, BASHKIA ELBASAN

Bashkia Elbasan.

Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Elbasanit. Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 banorësh dhe me densitet prej 236.11 banorë për km². Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km². Kjo bashki përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra e cila është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t'u administruar.



RAYS

Reconnecting Albanian Youth and Society

Ky buletin u publikua me mbështetjen e projektit RAYS, i cili zbatohet në Shqipëri nga Palladium. Përmbajtja e buletinit jo domosdoshmërisht shpreh qëndrimet e projektit apo partnerëve që e zbatojnë.

NË BRENDËSI

- | | |
|----|---|
| 4 | FJALA E DREJTUESIT
TË PROKURORISË SË
RRETHIT GJYQËSOR
ELBASAN Z. KRESHNIK
AJAZI |
| 5 | FJALA E DREJTUESIT TË
EKIPIT TË PROJEKTIT RAYS
Z. REDION QIRJAZI |
| 6 | AKTUALITET |
| 19 | SPORT |
| 21 | RINIA |
| 28 | REPORTAZH |

FJALA E DREJTUESIT TË PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN Z. KRESHNIK AJAZI



ne kemi një detyrë aq sa profesionale dhe ligjore, aq edhe si prindër dhe qytetarë, që t'u tregojmë të rinjve veçanërisht, se krimi nuk është rruga që duhet ndjekur

Kreshnik Ajazi

Të dashur lexues!

Personalisht ndjej gjithnjë një kënaqësi të veçantë teksa marr pjesë në mbledhjet e KVSP të Bashkisë Elbasan si dhe në të gjitha aktivitetet që realizohen në kuadër të këtij organizimi. Në çdo rast, dalja përballë opinionit publik qytetar dhe intelektual të Elbasanit, është jo vetëm një sfidë por edhe letërlakmushi, koloriti i së cilit tregon imazhin e prokurorisë në sytë e qytetarëve.

Ne kemi një detyrë aq sa profesionale dhe ligjore, aq edhe si prindër dhe qytetarë, që t'u tregojmë të rinjve veçanërisht, se krimi nuk është rruga që duhet ndjekur dhe nuk duhet të jetë kurrësi një alternative në jetë. Krimi nuk është e ardhmja dhe përballë çdo krimineli që tenton të paraqitet si model për shoqërinë, ne do të fitojmë duke promovuar modelet e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve që mbartin vlera të larta intelektuale dhe kulturore, që janë qytetarë të denjë për shoqërinë, që kontribuojnë çdo ditë për të ndërtuar një të ardhme të ndritur për qytetin tonë.

Prandaj unë e vlerësoj maksimalisht KVSP si një instrument nëpërmjet së cilit ne kemi mundësinë jo vetëm të marrim përshtypjen e opinionit publik të Elbasanit mbi performancën e punës sonë, por edhe të shënojmë shqetësimet reale të publikut të përcjella në KVSP përmes burimeve të ndryshme multiaktoriale që e përbëjnë këtë këshill.

Sot më shumë se kurrë më parë, ndërsa vendi ynë progreson mundimshëm në rrugën e integritit europian, lind nevoja të krijojmë dhe forcojmë një aleancë qytetare mes të gjithë aktorëve të jetës publike në Elbasan, për të treguar që jemi një shoqëri e cila i përket natyrshëm rendit të familjes europiane dhe për këtë arsye i jep përparësi vlerave më të larta të një shoqërie të shëndoshë dhe reaktive ndaj çdo fenomeni kriminal.

Sa më shumë organizime të kësaj natyre, sikundër është KVSP, të ekzistojnë në qytetin e Elbasanit aq më i fortë do të jetë zëri ynë dhe aq më të sigurtë do të ndihemi ne në përgjigje ndaj çdo fenomenimi kriminal kur mendojmë se kemi në krah qytetarët e Elbasanit. Më besoni, përkrahja juaj është burim force.

Një qytet i paqtë dhe i sigurtë, një shoqëri që përballlet dhe nuk fshihet, një rini që angazhohet drejt modeleve të suksesshme, që prosperon kah arsimit dhe jetës aktive, një shtresë qytetare dhe intelektuale që reagon dhe nuk hesht dhe një sistem drejtësie që lufton kundër krimit me njerëz dinjitoz dhe të papërkulshëm, janë sfida që duhet t'i kalojmë me sukses si detyrime ndaj fëmijve tanë.

Sinqerisht
Kreshnik Ajazi
Drejtues i Prokurorisë së Elbasanit

FJALA E DREJTUESIT TË EKIPIT TË PROJEKTIT RAYS Z. REDION QIRJAZI



Redion Qirjazi



Projekti ynë ka si mision t'u prezantojë të rinjve mundësi alternative për të ardhmen e tyre si dhe të nxisë ndjenjën e përkatësisë me komunitetin ku jetojnë

Ka qenë kënaqësi dhe privilegj për stafin e RAYS të bashkëpunonte me Bashkinë Elbasan gjatë këtij viti të parë të projektit tonë. Falë vizionit të përbashkët që Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja ndan me ne, RAYS i ka gjetur dyert e hapura për t'u angazhuar në disa projekte me të rinj të qytetit ashtu si edhe me institucione e organizata jo-qeveritare.

Projekti ynë ka si mision t'u prezantojë të rinjve mundësi alternative për të ardhmen e tyre si dhe të nxisë ndjenjën e përkatësisë me komunitetin ku jetojnë. Mbështetja e institucioneve publike dhe partnerëve të tjerë komunitarë ka qenë instrumentale në përmbushjen e këtij objekti.

Aktualisht RAYS është duke implementuar një sërë aktivitete me të rinj dhe institucione, ndër të cilat spikasin: forumi i aktivizimit rinor Të Flasim Rini (Let's Talk Youth), trajnimet në arte marciale të të rinjve të qytetit përmes programit Rrugëtime Sportive, trajnimi i psikologëve dhe punonjësve socialë mbi metodat e reja të Rrëfimeve Muzikore, trajnimi i praktikuesve të metodave artistike në punën me të rinjtë përmes programit Të Krijosh Mjedise

Muzikore, bashkëpunimi me institucionet vendore në grumbullimin e të dhënave për studimin Vlerësimi i Kërcënimeve Strategjike për Sigurinë Publike: Elbasan, dhe nxitja e të rinjve të Elbasanit të zbulojnë talentet e tyre artistike përmes programit Modë dhe Dizajn (Fashion and Design).

RAYS ka pasur sukses të jashtëzakonshëm në qytetin e Elbasanit! Kjo, jo vetëm falë përkushtimit të drejtuesve por, mbi të gjitha, falë pasionit të palëkundur të të rinjve me të cilët ne kemi punuar, të cilët na frymëzojnë dita-ditës për të besuar se jemi në rrugën e drejtë.

Jemi shumë entuziastë për të ardhmen e bashkëpunimit me partnerët tanë më të rëndësishëm, të rinjtë e Elbasanit.

Redion Qirjazi
Drejtues Ekipi

1. "KRYETARI MË MIQËSOR ME ROMËT 2022", KOMISIONI EUROPIAN VLERËSON KRYEBASHKIAKUN GLEDIAN LLATJA



Kryetari i bashkisë së Elbasanit, Gledian Llatja është vlerësuar nga Komisioni Europian me çmimin "Kryetari më Miqësor me Romët 2022".

Çmimi njih ato autoritete lokale që besojnë në qytetarët e tyre dhe i trajtojnë ata në mënyrë të barabartë. Ai synon të ndryshojë qëndrimet ndaj përfshirjes së romëve dhe vlerëson autoritetet lokale që u japin pushtet komuniteteve rome dhe dëgjojnë nevojat

e tyre. Ceremonia e ndarjes së çmimeve u zhvillua në kuadër të Javës së Romëve të organizuar në Parlamentin Europian (16-19 Maj) në prani të eurodeputetit Romeo Franz dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Fqinjësisë dhe Zgjerimit të Komisionit Europian (DG NEAR) Michela Matuella, e cila bëri edhe ndarjen e çmimeve.

Në fjalën e tij, Oliver Varhelyi, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, tha: "Mendoj se ceremonia e ndarjes së çmimeve gjatë Javës Rome të Parlamentit Europian është veçanërisht e rëndësishme. Ky çmim jo vetëm që vlerëson punën e jashtëzakonshme të kryebashkiakëve të përzgjedhur në thyerjen e barrierave midis autoriteteve lokale dhe komuniteteve Rome, por gjithashtu u tregon politikëbërësve, aktivistëve dhe ekspertëve se ndryshimi është i mundur. Unë jam vërtet i frymëzuar nga përkushtimi i fituesve të këtij viti për fuqizimin dhe mobilizimin e komuniteteve rome dhe forcimin e aftësisë së tyre për t'u përfshirë në dialog me autoritetet publike. Jam krenar për secilin prej tyre dhe shpresoj që ky çmim të frymëzojë të tjerët që të ndjekin shembullin e tyre."

Ky vlerësim është frut i një pune dhe përkushtimi të Bashkisë Elbasan, partnerëve lokalë e ndërkombëtarë në arritjen e gjithëpërfshirjes, me rezultate të dukshme në proceset vendimmarrëse lokale, investimet në infrastrukturë, arsim dhe punësim.

Në fjalën e tij në ceremoninë e marrjes së çmimit kryebashkiaku Llatja theksoi se: "Në

tre vitet e fundit, nga koha kur jam zgjedhur kryetar i bashkisë së Elbasanit, kam pasur mundësinë të kontribuoj dhe të dëshmoj arritjet në rigjallërimin dhe zhvillimin e minoritetit Rom. Mandatin tim e kam nisur me hartimin dhe vënien në zbatim të Planit Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2019-2022. Një dokument i prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European dhe Këshillit të Europës”.

Duke iu drejtuar anëtarëve të Parlamentit European, Llatja renditi edhe disa sfida, të cilat mund të përballohen përmes ndjekjes së një strategjie gjithëpërfshirëse, siç janë, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi



dhe arsimi profesional, lufta kundër gjuhës së urrejtjes, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban etj.

2. BASHKIA E ELBASANIT, PROJEKT AMBICIOZ PËR MJEDISIN



Gjatë vizitës në Bruksel në ceremoninë e organizuar nga Parlamenti European për akordimin e titullit “Kryetari më Miqësor me Romët 2022”, kryebashkiaku Gledian Llatja ka zhvilluar një takim me eurodeputetin Ciaran Cuffe. Ky takim u zhvillua para se eurodeputeti të raportonte para Parlamentit European për ecurinë e Shqipërisë.

Në këtë takim, z. Llatja i shprehu z. Cuffe mirënjohjen e thellë se sa shumë po ngre zërin në zemër të familjes së madhe European, për hapat e bërë nga Shqipëria drejt realizimit dhe plotësimit të kushteve për mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Gjithashtu, z. Llatja theksoi

se së shpejti Bashkia Elbasan do të lançojë projektin ambicioz për Elbasanin, falë mbështetjes që Bashkimi European po jep në mjedis, ndryshimet klimatike dhe teknologji.

Elbasani është përzgjedhur si një nga 12 bashkitë jashtë BE-së për projektin e 100 qyteteve neutrale ndaj karbonit deri në vitin 2050, ku deri në vitin 2030 ne do të fillojmë me hapat e para dhe do kemi projekte të ndryshme.

Z. Llatja i shprehu z. Cuffe se ky është një lajm shumë i mirë për dashamirësit e mjedisit, ambientalistët, qytetarët e Elbasanit por edhe për shoqërinë civile të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejt mund të aplikojnë në ato projekte të vogla që ne kemi diskutuar bashkë sidomos për murin e gjelbër, si dhe me mundësi fantastike për të rinjtë”.

3. JAVA E DEMOKRACISË, RRJETËZIM NDËRMJET QYTETEVE SHQIPTARE DHE NORVEGJEZE



Në kuadrin e Konsortiumit mes Pushtetit Lokal dhe organizatave të Shoqërisë Civile për vullnetarizmin e qëndrueshëm në Shqipëri, kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja ka marrë pjesë në vizitën studimore të zhvilluar në qytetin e Kristiansand të Norvegjisë në datat 1-4 Maj 2022. Në këtë vizitë morën pjesë përfaqësues nga Bashkia Tiranë, Bashkia Elbasan, Bashkia Korçë, Bashkia Pogradec, Bashkia Lushnjë, Bashkia Berat, Bashkia Shkodër dhe Bashkia Tropojë në bashkëpunim me PVN Albania, Kongresi Rinor Kombëtar, Lobi Euro Atlantik Shqiptar (dega Norvegji) dhe Batteriet Sør.

Qëllimi i vizitës ishte njohja, kuptimi dhe reflektimi sesi Shqipëria mund të përshtatë disa nga politikat, modelet, praktikat dhe metodologjitë për krijimin e vullnetarizmit të qëndrueshëm. Për më tepër, vizita u organizua në Javën e Demokracisë ku të gjitha palët e interesuara të Kristiansand u mbledhën për të diskutuar sesi një qytet mund të jetë më demokratik dhe më i aksesueshëm.

Nëpërmjet takimeve të zhvilluara, delegacioni shqiptar u njoh me funksionimin e vullnetarizmit në Kristiansand. Përfaqësues



...kryetari i Bashkisë së Kristiansand, siguroi në bashkëpunimin e mëtejshëm midis bashkive reciproke.

nga partitë politike të Norvegjisë shpjeguan qasjen e tyre ndaj vullnetarizimit si edhe caktimin e prioriteteve dhe marrjen e vendimeve.

Gjithashtu, delegacioni zhvilloi takim me zv Presidenten e parlamentit në nivel kombëtar znj K Henriksen, e cila tregoi se si mbështetjet vullnetarizmi dhe përkushtimin e saj për të bashkëpunuar me Shqipërinë.

Së bashku me Kryetarin e Bashkisë, z. Jan Oddvar Skisland, z Llatja pati mundësinë për të bërë hapjen zyrtare të Javës së Demokracisë. Gjithashtu, Kryetari i Bashkisë së Kristiansand, siguroi në bashkëpunimin e mëtejshëm midis bashkive reciproke.

Vizita u pasua nga takime me organizatat e shoqërisë civile lokale dhe rajonale nga Norvegjia, përfaqësues të Dhomës së Tregtisë, ku u diskutua rreth mundësive për rritjen e prezencës së sipërmarrësve norvegjezë në Shqipëri, me një fokus të



veçantë në sektorin e turizmit.

4. DËGJESË PUBLIKE E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË SIGURISË PUBLIKE



Z. Llatja, theksoi se KVSP-ja ka si qëllim angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve publikë dhe jo-publik në nivel lokal e më tej

Puna e Këshilli Vendor të Sigurisë Publike, ka marrë një vëmendje të veçantë edhe nga deputetët e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare të drejtuar nga Nasip Naço të cilët u njohën nga afër me punën e këtij mekanizmi.

Në takim u bë një përmbledhje e punës dhe veprimtarisë së KVSP në Bashkinë Elbasan, ku pjesëmarrësit u njohën me mënyrën e funksionimit të këtij mekanizmi dhe vlerësuan angazhimet e ndërmarra në kuadër të planit shumaktorial vendor ku ndahen përgjegjësitë midis gjithë aktorëve

të përfshirë si: bashkia, policia, prokuroria, shkollat, biznesi, OJF-të, struktura qytetare, etj.

Z. Llatja, theksoi se KVSP-ja ka si qëllim angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve publikë dhe jo-publik në nivel lokal e më tej, kjo në funksion të parandalimit dhe adresimit të sfidave dhe kërcënimeve të lidhura me sigurinë publike.

Deputetët vlerësuan punën e KVSP në Elbasan, komentuan çështje që kanë të bëjnë me përmirësime të mundshme të bazës ligjore në funksion të konsolidimit

të mëtejshëm të këtij instrumenti të rëndësishëm. Kryetari i Komisionit për Sigurinë Kombëtare z. Nasip Naço, në emër të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, garanto mbështetjen për KVSP Elbasan si dhe kërkoi koordinimin për zhvillimin e takimeve më të zgjeruara në të ardhmen.

Gjithashtu, z. Naço pranoi mundësinë për të zhvilluar edhe një seancë dëgjimore në Komisionin e Kuvendit të Shqipërisë për të vlerësuar nga i gjithë komisioni nevojën e përmirësimeve ligjore në mbështetje të kësaj përvoje, në shërbim të përmirësimit të sigurisë publike.

5. KONFERENCA "PUSHTET VENDOR-SHOQËRI CIVILE" PËR VULLNETARIZËM TË QËNDRUESHËM NË NIVEL LOKAL



Në kuadër të Konsortiumit "Pushtet Lokal-Shoqëri Civile", PVN Albania organizoi Konferencën e dytë Kombëtare: "Pushtet Vendor-Shoqëri Civile 2.0" për Vullnetarizëm të Qëndrueshëm Lokal ku morën pjesë Kryetarë, Nënkryetarë, Drejtues Kabinetesh, Koordinatorë të vullnetarizmit dhe administratës nga 8 Bashkitë pilot, pjesë e kësaj iniciative.

Në këtë konferencë ishte i pranishëm edhe kryetari i Bashkisë z. Gledian Llatja i cili theksoi se "kjo konferencë erdhi me risi në

Zgjerimin Lokal ku secilës prej 8 Bashkive pilot ju bashkuan aktorë lokal strategjik në nxitjen e vullnetarizmit lokal si: OSHC lokale, Zyra Vendore Arsimore; Shkolla të mesme, Universitete, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim; Qendra Rinore / Komunitare / Multidisiplinare, Institucione Shëndetësore dhe Prefektura.

Në fokusin e kësaj konference ishte ndarja e modeleve të mira ndërkombëtare falë vizitës shumë të fryshme në Norvegji; modeleve rajonale falë bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së Regional Youth Cooperation Office – Ryco dhe atyre kombëtare falë kontributit të Lëviz Albania, si edhe diskutime e analiza rreth kuadrit ligjor dhe perspektivave në vijim.

Kjo nismë vijon të jetë e qëndrueshme dhe vizionare falë bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve dhe veçanërisht angazhimit dhe vendosmërisë së Bashkive.

Drejtoresha Ekzekutive e PVN Albania, Znj. Oltiana Rama theksoi se "bashkëpunimi dhe dialogu ndërmjet institucioneve janë thelbi për përgatitjen e një terreni të qëndrueshëm, profesional dhe të sigurt për nxitjen e vullnetarizmit, derisa vullnetarizmi të bëhet

mendësi dhe kulturë institucionale dhe individuale”.

Sekretarja e Përgjithshme e Kongresi Rinor Kombëtar, Znj. Dafina Peci theksoi rëndësinë e qëndrueshmërisë së këtij bashkëpunimi dhe vijimin me hapa të qëndrueshëm të kësaj iniciative.

Bashkitë ritheksuan se ky ridimensionim i vullnetarizmit kërkon angazhimin e të gjithëve, dhe Bashkitë kanë rol kyç për të mbështetur çdo hap dhe të kenë rol proaktiv duke përgatitur terren të përshtatshëm brenda institucionit por edhe duke adresuar gjithë sfidat në mënyrë të përbashkët.

Që nga lancimi i kësaj iniciative më 08 Shtator 2021, konsortiumi ka bërë një rrugëtim shumë interesant dhe me impakt, duke kryer një analizim të thelluar të situatës së vullnetarizmit në Bashkitë Pilot, ngritur



struktura apo vendosur punonjës të dedikuar për vullnetarizmin, ofruar trajnime kapacitet-ndërtuese për punonjësit e angazhuar në këtë çështje dhe filluar punën për hartimin e Planeve Vendore të Veprimit për Vullnetarizmin.

6. TË JESH VULLNETAR, DO TË THOTË TË DUASH JETËN



...një ndihmesë të madhe në shuarjen e zjarreve vullnetarisht kanë dhënë edhe rinia e Elbasanit...

Për të përballuar situatat e emergjencave civile, kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, dhe stafi i Bashkisë Elbasan, kanë ngritur grupet e punës, si në Sektorin e Zjarrëfikëses, ashtu edhe në mbarë territorin e Bashkisë së Elbasanit.

Kryetari i Bashkisë u ka bërë thirrje administratorëve të pallateve, kryepleqve, në fshatra dhe zona informale, që të aktivizohen masivisht dhe t'i vijnë në ndihmë efektivave të zjarrëfikësve në rast se konstatohet zjarr në zonat ku ato banojnë. Një ndihmesë të

madhe në shuarjen e zjarreve vullnetarisht kanë dhënë edhe rinia e Elbasanit, e cila sa herë që është konstatuar zjarr në pyje dhe kodrina ka qenë e pranishme duke ndihmuar vullnetarisht për shuarjen e flakëve.

Vullnetarë në shuarjen e flakëve të rëna gjatë periudhës së verës në kodrinat dhe ullishtat e Elbasanit, kanë qenë edhe punonjës të administratës së Bashkisë të cilët janë bërë pjesë e aksioneve për shuarjen e flakëve aty ku nuk kanë mundësi të ndërhyjnë mjetet e zjarrëfikëses.

7. LLATJA: BASHKIA, ANGAZHIM PËR TRANSPARENÇË NDAJ QYTETARËVE



Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ishin në qendër të një takimi të zhvilluar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me institucionet e qarkut të Elbasanit. Në këtë takim, të organizuar në kuadër të projektit “Ditët e transparencës”, komisioneri Besnik Dervishi falënderoi kryetarin e bashkisë, Gledian Llatja, prefekten e qarkut, si dhe të pranishmit duke pohuar se “Elbasani është një nga qarqet me bagazh intelektual dhe kulturor”.

Në fjalën e tij, kryetari i bashkisë Gledian Llatja, tha se *“praktikat më të mira të qeverisjes vendore e konsiderojnë transparencën si moment historik të qeverisjes së mirë dhe komuniteteve të forta. Transparenca e institucioneve vendore lufton korrupsionin, rrit besimin e qytetarëve dhe forcon integritetin e institucioneve publike”*.

Sipas kryebashkiakut, ky proces u mundëson qytetarëve të vlerësojnë objektivisht cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike, duke propozuar ndryshime për përmirësimin e shërbimeve të ofruara.

Transparenca e institucioneve vendore është një parakusht për një qeverisje të hapur dhe demokratike. Nga ana tjetër, qeverisja e hapur është më shumë e kontrollueshme nga qytetarët, pasi qasja në informacione publike u mundëson qytetarëve të jenë më shumë informuar për aktivitetin e bashkisë.

“Aksesi në informacionin publik është një e drejtë themelore e njeriut dhe a hapi i parë drejt demokracisë pjesëmarrëse lokale. Nëpërmjet Programit të Transparencës, bashkia Elbasan vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato”, theksoi Llatja.

Për garantimin e të drejtës së informimit, bashkia në hartimin e Programit të Transparencës është bazuar në parimin e vendosjes në dispozicion të çdo qytetari, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë.

Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies lokale nga shoqëria civile ka gjithashtu një rëndësi të veçantë në nxitjen dhe promovimin e angazhimit qytetar në proceset vendimmarrëse. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është parësore për forcimin e demokracisë lokale dhe minimizimin e praktikave korruptive.

Bashkia e Elbasanit synon ofrimin e qeverisjes së mirë duke inkurajuar akses dhe pjesëmarrje të publikut për të garantuar që vendimmarrja të përgjigjet ndaj nevojave të përbërësve të tij dhe të pranojë opinionet e tyre, të ofrojë shërbime me cilësi të lartë për qytetarët e saj dhe promovuar përdorimin efikas të burimeve publike.

8. "NË FAMILJE PËR FAMILJEN" TAKIM PËR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË NË KOMUNITET

Mbledhja e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike të Bashkisë Elbasan, vijoi me një aktivitet nga organizata "Në familje, për familjen", grantmarrëse e raundit të 5-të të skemës së granteve, e cila sapo përfundoi me sukses projektin "Zhvillimi i qëndrueshëm nis me sigurinë publike" i cili u realizua në tre bashki të Qarkut Elbasan.

Aktiviteti u realizua nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja.

Në takim ishin të pranishëm Kryetari i Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Hektor Çiftja, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave anëtare të KVSP Elbasan dhe sekretariatet teknike të Bashkisë Elbasan, Prokurorisë Elbasan dhe Komisarariatit të Policisë, përfaqësues të organizatës "Në familje, për familjen" dhe ekspertë të SCPA.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja e KVSP Elbasan me gjetjet e Anketimit "Sistemi i Matjes së Sigurisë në Komunitet 2022 (SMSK)" i cili u mbështet nga Programi "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" (SCPA) i financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe zbatohet në Shqipëri nga kompania FCG Sweden. Kryetari i Këshillit Bashkiak Elbasan z. Hektor Çiftja vlerësoi mbështetjen afatgjatë të SCPA në Bashkinë Elbasan dhe u ndal në domosdoshmërinë e të dhënave periodike për të kuptuar vlerësimin e komunitetit ndaj punës së KVSP dhe Bashkisë Elbasan për sigurinë publike.



Z. Ervin Muço, pohon se "ky anketim është një mekanizëm shumë i vlefshëm për të kuptuar jo vetëm perceptimin e komunitetit por edhe për të orientuar punën tonë të përbashkët për përmirësimin e sigurisë publike në Bashkinë Elbasan dhe përmirësuar perceptimin e komunitetit.

Znj, Kristina Kreka –sekretariati teknik Bashkia Elbasan u ndal në mundësinë e aksesit në të dhënat SPSS të anketimit për të ndërtuar në të ardhmen veprimtarinë e përbashkët në kuadër të sigurisë publike.

Znj, Rezarta Sheshaj- përfaqësuese e NFPF u shpreh se bazuar në gjetjet e anketimit, aktiviteti i organizatës sonë do të fokusohet në zonat e rrezikut të evidentuara në anketim. Pjesmarrësit vlerësuan rëndësinë e anketimit dhe gjetjeve të tij, dhe mbi të gjitha, mundësisë e aksesit të të dhënave për t'i përdorur në punën e tyre për përmirësimin e sigurisë publike në Bashkinë Elbasan.

9. FORUMI I GRUAS ELBASAN

Në kuadër të realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin Ndërinstitucional për parandalimin e Krimit në Elbasan (Pika 5), të

hartuar nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, FGE ka vijuar punën e saj në mbrojtjen e të drejtave të grave duke ofruar shërbime

konkrete ndaj të mbijetuarave nga dhuna në familje/gjinore.

Gjithashtu, FGE organizon aktivitete ndërgjegjësuese, që përhapin mesazhe parandaluese dhe kurajuese për të mos heshtuar dhe për të denoncuar dhunën. Në këtë kontekst, janë zhvilluar takime me gra/vajza, burra/djem në zonat rurale dhe urbane, me të rij nxënës e studente për ndërgjegjësimin publik dhe promovimin e vlerave të përbashkëta.

Aktivitete ndërgjegjësuese/parandaluese komunitetet fetare, me pjesëmarrjen

edhe të klerikeve fetarë për rolin e tyre në parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit/radikalizmit.

Pjesë e rëndësishme është edhe puna e FGE-së, në kuadër të Programi "**Empowerment through Self-defense**" (Fuqizim nëpërmjet vetëmbrojtjes) në Shqipëri, i cili u ofron të rinjve, vajza dhe djem, mundësinë për të punuar drejt zhvillimit personal, përmirësimit dhe fuqizimit të vetes. Konkretisht në Bashkinë Elbasan janë zhvilluar 15 takime me nxënës të shkollave të mesme (me nga 20 pjesëmarrës), si dhe 7 trajnime me psikologë, punonjës sociale dhe oficerë sigurie.

10. QENDRA E BASHKËPUNIMIT NDËRFETAR



Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar në Elbasan (QBNFE) është një organizatë që synon krijimin e mundësive reale për dialog dhe bashkëpunim të vazhdueshëm midis udhëheqësve fetarë dhe komuniteteve të tyre për të rritur dhe forcuar gjithnjë e më tej mirëkuptimin dhe bashkëjetesën fetare në vend e më gjerë, si edhe për të penguar individë e grupime të ndryshme që keqpërdorin fenë në dëm të shoqërisë dhe njerëzimit.

E iniciuar në vitin 2003 dhe e themeluar në 2005 nga udhëheqësit shpirtërorë të katër komuniteteve fetare tradicionale të Qarkut të Elbasanit, përkatësisht nga Komunitetet; Mysliman, Katolik, Ortodoks dhe Bektashi dhe prej vitit 2018 QBNFE-së iu bashkua

edhe komuniteti i pestë fetar, Vëllazëria Ungjillore.

QBNFE është anëtare e KVSP Elbasan që prej themelimit të këtij të fundit duke dhënë kontributin e saj në një sërë aktiviteteve në dobi të bashkësive fetare, banorëve të Elbasanit dhe më gjerë, nën frymën e njohjes dhe dialogut të ndërsjelltë në respekt të vlerave individuale dhe kolektive të gjithsecilit. Fushat kryesore të punës së QBNFE janë:

- Dialogu dhe bashkëpunimi ndërfetar midis komuniteteve, i promovuar edhe jashtë Shqipërisë;
- Marshimi i paqes: një nga veprimtaritë më të rëndësishme e tepër të dukshme të bashkëpunimit.





- Simpoziume e konferenca te rëndësishme mbi harmoninë fetare në universitete dhe ambientet e tjera publike.

- Fushata ndërgjegjësuese dhe takime mbi parandalimin e ekstremizmit ne shkolla dhe komunitetet.
- Fushata ndërgjegjësuese dhe takime për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Bashkëpunimi me aktorë dhe institucione të rëndësishme si brenda dhe jashtë vendit për forcimin e vazhdueshëm të vëllazërisë njerëzore që kulmon me Takimin dhe bekimin nga Papa Francesku.

11. TJETËR VIZION

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të parashikuara nga Planin e Veprimit të KVSP, Tjetër Vizion, ka vijuar, nëpërmjet Njësive të Lëvizshme për Identifikimin, referimin dhe mbështetjen me shërbime të viktimave të mundshme të trafikimit. Metodologjia e punës së këtyre skuadrave është bazuar në një identifikim proaktiv në mjedise publike, shkolla, zona administrative të njohura për shkallën e lartë të vulnerabilitetit social-ekonomik, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Elbasan.

Gjithashtu, është punuar me ngritjen e kapaciteteve me anëtarët e KRAT-it në Elbasan. Gjatë periudhës Janar-Shtator 2021 u dizenuan 2 module trajnimi: i pari për rritjen e identifikimit të VT-ve gjatë situatave emergjente dhe, i dyti, i dedikuar për sistemin arsimor për identifikimin proaktiv të VT dhe në rrezik trafikimi/abuzimi të minoreneve të përfshirë në situatë abuzimi.

Rreth 45 familje të fëmijëve dhe të rinjve në situatë vulnerabël janë asistuar dhe mbështetur për arsim, punësim, formim profesional dhe trajnime në punë, mbështetje financiare, etj. Gjatë kësaj periudhe, Tjetër Vizion ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve direkte për asistencë për 49 minoreneve VMT.

Janë shpërndarë rreth 1000 fletë-palosje informuese për shërbimet për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Rreth 4500 persona janë informuar përmes fushatave të informimit. Janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në gjashtë shkolla 9-vjeçare të qarkut Elbasan për promovimin e të drejtave të fëmijëve përmes teatrit forum.

Janë realizuar 552 seanca të këshillimit individual, 10 terapi grupi dhe 12 biseda në grup me 23 raste, në varësi të nevojave që ato paraqesin. Tjetër Vizion ka ofruar shërbimin e këshillimit për 41 gra dhe 6 burra. Njëkohësisht, është ofruar ndihmë ligjore për 6 gra.

Problematikat kryesore që janë hasur gjatë këshillimeve individuale dhe në grup lidhen me situatat e trafikimit, dhunës, abuzimit seksual dhe situatat e tjera të vështira në të cilën janë gjendur përfitueset, si emocionalitet të paqëndrueshëm, gjendje ankthi, problematika në sjellje, çrregullime të personalitetit, problematika me gjumin dhe ëndrrat, probleme në sjellje, problematika psikotike etj.

12. HISTORIA E NJË QYTETI PËRMES TINGUJVE



Profesionistët e qytetit të Elbasanit trajnim 2- ditor mbi teknikat e peisazhit tingëllor (soundscape).

Keni menduar ndonjëherë të përshkruani qytetin tuaj përmes tingujve? Apo të tregoni historinë e tij përmes peisazhit tingullor?

Kjo pyetje iu bë 13 profesionistëve të qytetit të Elbasanit, mësues muzike, mësues arti e psikologë të cilët punojnë me të rinjtë. Të ftuar të ndiqnin trajnimin e organizuar nga projekti RAYS nën drejtimin e Dr. Panos Amelidis, profesor i muzikës dhe teknologjisë së zërit pranë Universitetit të Bournemouth në UK ata u njohën me teknikat e tregimit të historisë përmes tingujve, ajo që quhet peisazh tingullor (soundscape).

"Sot ne nuk i kushtojmë shumë rëndësi tingujve, jemi të përqëndruar tek fotot, por përmes tingujve mund të rrëfesh histori të jashtëzakonshme njerëzore", - thotë Dr. Amelidis.

Dhe për ta dëshmuar këtë ai ftoi profesionistët Elbasanas, të pranishëm në trajnim, të shëtisnin rreth e përqark Kalasë së Elbasanit, të rregjistronin tinguj me aparatet celularë dhe më pas të përgatishnin një peisazh tingullor përmes programeve të dedikuara në kompjuter me të cilat u njohën gjatë trajnimit.

Imagjinoni një qytet si Elbasani që gëlon nga zhurma e makinave, bisedat e njerëzve, të qeshurat e fëmijëve, cicërimat e zogjve, zërat e tregtarëve ambulante, porosia për një bugaçë...gjithçka që ndodh në një qytet, e rrëfyer përmes tingujve.

Ky trajnim me profesionistë të qytetit të

Elbasanit është krijuar për të ndërgjegjësuar profesionistët për tingujt dhe peisazhet zanore që na rrethojnë. Sot peisazhi tingullor është një teknikë që i jep rëndësi përvojës dëgjimore, e cila mund të kontribuojë në ndjenjën e "përkatësisë" ndaj një komuniteti dhe mjedisit. Përveç kësaj, ai synon të ndihmojë të rinjtë apo të gjithë ata që shfaqin interes të zbulojnë botën e padukshme, por magjike të tingujve.

Shumë e përqëndruar për të hedhur në programin e dedikuar për kompozimin e tingujve që rregjistroi ishte Mimoza, mësuese në ciklin 9-vjeçar. Dëshironte shumë ta përvetësonte menjëherë programin në mënyrë që njohuritë e fituara t'i ndante me nxënësit. "Është shumë interesante, dhe mendoj se të rinjtë sot, atë që mendja jonë nuk e pranon, ata e përvetësojnë me shumë lehtësi. Ashtu si mësojnë notin mësojnë edhe risitë edhe këtë risi (peisazhin tingullor) mendoj se do ta aplikojnë këndshëm" shprehet Mimoza.

Teksa shpjegon më shumë rreth kësaj teknike dhe përdorimit të peisazhit tingullor, Dr. Amelidis u shpjegon profesionistëve që do të punojnë me të rinjtë se ata duhet ta shohin kompozimin e peisazhit tingullor si një mënyrë alternative për të treguar një histori. "Ky trajnim i ndihmon të rinjtë të tregojnë histori nëpërmjet tingujve dhe të ndërgjegjësojnë komunitetin rreth fenomeneve apo problematikave që duan të trajtojnë", shprehet ai. Sipas tij temat mund të jenë nga më të ndryshmet, pasi çdo gjë mund të rrëhefet përmes tingujve.

Trajnimet me profesionistët synojnë të përgatishin mësues dhe praktikues në kompozimin e peisazheve tingullore, të cilët më pas do ta përdorin këtë teknikë në klasë me nxënësit e tyre. Në ndihmë u vjen udhërrëfyesi teknik i përgatitur nga Dr. Panos Amelidis për teknikat e kompozimit të peisazhit tingullor, i cili në vijim do të integrohet në manualin e plotë që do të kombinojë aspektet teknike me udhëzime konkrete për përdoruesit e tij.

"Thuhet se 'tingulli flet' prandaj duhet ta përdorim për të ndihmuar të rinjtë

në nevojë që ndihen të përjashtuar dhe të marginalizuar”, shprehet një nga të pranishmit gjatë diskutimeve.

Projekti RAYS identifikoi krijimin e peizazheve tingullore si një mënyrë jo tradicionale për të rinjtë për të ndarë historitë e tyre dhe që mund t’i ndihmojnë praktikuesit të identifikojnë problematikat mes të rinjve.

Pas trajnimit të profesionistëve, trajnimet e tjera do të vijojnë me të rinjtë. Projekti RAYS, Rilidhja e Rinisë dhe Shoqërisë Shqiptare, një projekt i financuar nga qeveria britanike që zbatohet nga Palladium dhe partnerët e tij synon përmes këtyre aktiviteteve të pajisë të rinjtë me aftësi të reja dhe tërheqëse për tregun e punës. Këto janë aftësi që përdoren sot në industrinë e medias, atë të filmit,



teknikat e regjistrimit të zërit dhe editimit të zërit. Në fund të këtij projekti të rinjtë do të mund t’i prezantojnë punët e tyre dhe do të kenë fituar aftësi të reja. Përmes këtyre mënyrave novatore ata do të jenë të aftët të përdorin tingujt për të treguar historitë e tyre dhe për të ndarë përvojat e tyre.

13. SPEKTAKLI GJENIU I VOGËL, BEFASON ME “GJENITË E VOGLA” TË ELBASANIT

Gjeniu i Vogël, një nga spektaklet më të mëdha të talenteve të vegjël, nuk mund të prezantohej, pa praninë e talenteve të vogla të qytetit të Elbasanit. Ndër vite, ky talent show, ka prezantuar artistet e vogla të qytetit tonë, të cilat që në vogëli, janë produkt i mësuësve të palodhur të Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Elbasan.

Këtë vit ky spektakël i sukseshëm, prezantoi katër finaliste nga Elbasani, të cilat me plot gojën themi se janë artistet e vogla, me pespektivën e madhe që në të ardhmen të vazhdojnë këtë zhanër të muzikës, duke u kthyer në këngëtare me zë në vendin tonë dhe më gjerë. Sergita Varfi, Françeska Kasa, Bletisia Karaj dhe Irsa Haxhillari janë vetëm disa nga fëmijët e talentuar që janë pjesë e QKF Elbasan, por që dolën në finalen e spektaklit “Gjeniu i Vogël”.

Ka qenë një punë e palodhur e stafit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, që këto katër artiste të vogla të ngjiten në skenë dhe të performojnë me plot emocion dhe profesionalizëm këngët e tyre. Nën drejtimin e Martin Kushi, dhe punës pasionante të profesor Limanit i cili prej vitesh ka nxjerrë

talente për Elbasanin, këto vajza erdhën në qytetin e tyre sërish me trofe. Rrallëherë nga një qytet kanë dalë katër finalist në një spektakël dhe kjo ndodh vetëm në qytetin e Elbasanit, i cili njihet si qyteti i artit, arsimit, e kulturës.

Sergita Varfi, 13 vjeçarja nga qyteti i Elbasanit vjen sërish me një trofe në qytetin e saj, finaliste në spektaklin e madh për talentët e vegjël Gjeniu i Vogël.

Nuk është hera e parë që ajo merr pjesë në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare dhe këto arritje në fushën e muzikës e motivojnë atë që të vijojë më tej rrugën e saj drejt këngës. Me një talent të lindur në artin e të kënduarit, Sergita beson në vetvete se në të ardhmen do të bëhet një këngëtare e madhe. Ajo pohon se do ta vazhdojë rrugëtimin drejt artit duke punuar dhe studiuar në këtë fushë. Talentin për të kënduar, Sergita dhe prindërit e saj e kanë zbulur që kur ajo ishte 5 vjeç, kur edhe nisi rrugëtimin drejt artit të të kënduarit, pikërisht në Festivalin Mbarëkombëtar në qytetin e Shkodrës. Që në këtë moshë, ajo vijon të jetë pjesë e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, aty edhe ku nisi hapat



© Erlind Vaja

Sergita Varfi, 13 vjeçarja nga qyteti i Elbasanit vjen sërish me një trofe në qytetin e saj, finaliste në spektaklin e madh për talentët e vegjël Gjeniu i Vogël.

Sergita dhe pasioni i saj për këngën

e parë të këndimit. Gjithashtu Sergita zhvillon dhe kursin e pianos prej disa vitesh. Ajo ka marrë pjesë në festivale ndërkombëtare brenda dhe jashtë Shqipërisë ku është vlerësuar me çmime të para dhe të dyta.

Ajo vijon të jetë aktive në festivalet që organizon Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe Bashkia Elbasan. Vitet e fundit, është pjesëmarrëse në disa disa programe televizive e ftuar e veçantë, si në RTSH, RTV Ora, Vizion Plus ku ka qenë pjesë e Gjeniu të Vogël. Rrugëtimi i saj ka qenë shumë i bukur tek Gjeniu i Vogël. Ajo ishte pjesë e finales, që siç thotë edhe vetë Sergita, "ka qenë një nga eksperiencat më të bukura".

Bletisa Karaj, finaliste e Gjeniu, një artiste e vogël, të gjithë meritat e saj ia dedikon Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Kam pothuajse 3 vite që marr pjesë tek Qendra Kulturore e Fëmijëve Elbasan dhe po ndaj me të gjithë lexuesit dhe bashkëmoshatarët e mi rrugëtimin tim gjatë këtyre viteve aty.

Jam regjistruar që kur isha në klasën e 7, fillimisht u regjistrova në kursin e kantos dhe këtë vit në kursin e pianos.

Në ditën time të parë si nxënëse tek kanto kam qenë pak e ndrojtur por nuk kaloi shumë dhe u ambientova si me skenën dhe me shokët dhe shoqet. Çdo herë që dal dhe performoj në skenë, për mua është një arritje dhe një emocion i veçantë. Kam marrë pjesë gjithmonë në aktivitetet e zhvilluara që prej ditës së parë. Disa prej tyre kanë qenë koncerte por edhe konkurse ku talentet e qendrës performonin për të marrë çmimet që ndaheshin. Unë tashmë kam marrë dy çmime

nga koncertet e 'Fest Folk' dhe 'Festivali i Interpretuesve'. Bënim dhe akoma bëjmë prova me profesorin tonë para koncerteve, që t'i falim publikut tonë dhe qytetit performancat e bukura që vijnë nga zërat e fëmijëve.

Jam shumë e lumtur që shoh fëmijë të vegjël që kanë dëshirën dhe pasionin të ndjekin ëndrrat e tyre dhe bëhen pjesë e Qendrës Kulturore që do promovojë talentet e reja (siç ka bërë me mua dhe me shokët e mi gjatë këtyre viteve). Si një artiste e vërtetë Bletisa ka besim në vetvete se do të bëhet një artiste e madhe në të ardhmen.



Bletisa, falenderon Qendrën Kulturore të Fëmijëve

14. AF ELBASANI U – 11 & U-13 SHPALLET KAMPION



Akademia e Futbollit Elbasani po jep frytet e veta që në vitin e parë të krijimit të saj. Pas arritjes së objektivave me skuadrën e të rriturve, kur u ngjiten nga Kategoria e Tretë në të Dytën, e njëjta gjë po ndodh edhe tek grupmoshat U-11 dhe U-13 të cilat janë shpallur kampionë në Ligën Rajonale të Qarkut Elbasan.

Elbasanasit siguruan vendin e parë me një bilanc tepër pozitiv në ekipin e 11 vjeçarëve, pasi në 34 javët e luajtura i fituan të gjitha, duke grumbulluar në fund 102 pikë. Ndërkohë, e njëjta situatë paraqitet edhe tek U-13, teksa nën një atmosferë festive, i pranishëm ishte edhe kryebashkiaku Gledian Llatja, i cili i dorëzoi edhe trofeun ekipit kampion. Nga ana e bashkisë, mbështetja

ndaj sportit nuk ka munguar asnjëherë dhe e tillë do të jetë edhe në vazhdim. Jemi shpresëplotë që e ardhmja e ekipit të Elbasanit është e sigurtë. Është një nismë e nisur një vit më parë ku shumë skepticistë ishin të çuditur me këtë vendimarrje dhe ecurinë që do kishte Akademia e Futbollit të Elbasanit. Sot, mbas një viti skuadrat dolën kampion në vitin e parë. Tashmë kemi vënë gurët e themelit, janë konsoliduar ato dhe po ngrihet një Akademi Futbolli e shëndetshme për Elbasanin. Një punë e mirë është bërë edhe tek grupmoshat më të vogla, ato U-7 dhe U-9, ku janë krijuar grupe të talentuar fëmijësh, të cilët konsiderohen si e ardhmja e këtij sporti në qytetin e Elbasanit.



15. ATLETIKË, KAMPIONËT E SKUADRËS SË ELBASANIT



Në "Elbasan Arena" janë mbajtur garat e kampionatit të 84-rt Kombëtar të Atletikës, me sportistët më të mirë shqiptarë që garuan në disiplina të ndryshme.

Bien në sy paraqitjet pozitive të atletëve elbasanas, të cilët u ngjitën edhe në podium, duke treguar një performancë në rritje. Spikati atleti Enea Zdrava, i cili doli i pari në garat e vrapimit 800 dhe 1500 metra. Vitet e fundit atleti elbasanas ka dominuar në garat e këtyre dy disiplinave, por pritshmëritë e tij janë të shkojë akoma edhe më lart. Pa ndihmën e familjes dhe të trajnerit të tij, Hamit Demiri, Zdrava nuk do ta kishte të lehtë për të marrë këto rezultate, ndaj edhe kjo paraqitje shkon për ta. Sa i përket rezultateve të tjera të atletëve të Elbasanit, Tirron Mamusha doli i pari në garën e 5 mijë metrave, Klea Kullolli zuri vendin e dytë në garat e 3 mijë metrave, ndërsa Amir Bahja doli i dyti në atë të 800 dhe 1500 metrave.

BASHKIA ELBASAN, PROGRAM PUNËSIMI PËR TË RINJTË ROMË DHE EGJIPTIANË

Përgjatë periudhës 2021-2022 Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan kanë mundësuar vënien në zbatim të programit të punësimit Punë Publike në Komunitet. Ky program 12-mujor,

ka si qëllim përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuesve të papunë afatgjatë nëpërmjet ofrimit të mundësive të trajnimit dhe të punësimit me kohë të pjeshme në aktivitete me fokus shërbimet në dobi të komunitetit.

Bashkia Elbasan duke bashkëpunuar me Lëvizjen Rinore Egjiptiane dhe Rome ka aplikuar dy projekte të ndryshme për zbatimin e këtij programi duke punësuar gjithësej 25 punëkërkues nga minoritetet Egjiptian dhe Rom.

Në projektin e parë janë punësuar 11 persona, të cilët ofrojnë shërbime në pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të gjelbërta të qytetit, ndërsa në projektin e dytë janë punësuar 14 persona, të cilët ofrojnë shërbime mbështetëse në pastrimin dhe mirëmbajtjen e disa shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.

Zbatimi i këtij programi punësimi ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e ekonomisë familjare të këtyre personave, si dhe në rritjen e aftësive për t'u përshtatur dhe integruar në tregun e punës.

Sakaq, në "Ditën Kombëtare të Egjiptianëve të Shqipërisë", Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome bashkë me një grup studentësh egjiptian zhvilloi një takim me kryetarin e Bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja. Në këtë takim u diskutuan dhe promovuan vlerat historike e kulturore të minoritetit Egjiptian, si dhe gjithësecili prezantoi arritjet akademike, por edhe sfidat me të cilat përballemi çdo ditë në aspektin e punësimit dhe gjithëpërfshirjes. Z. Llatja shprehu angazhimin dhe vullnetin e tij për të bashkëpunuar dhe mbështetur të rinjtë e këtij minoriteti për të ecur përpara drejt rrugës së integritit dhe përfshirjes shoqërore.

16. RINIA, BREZI MË AFËR EVROPËS



Në kuadër të "Javës së Evropës", Bashkia e Elbasanit ka organizuar një sërë aktivitete, një ndër të cilat ishte edhe ajo me Këshillin Rinor të qytetit ku mori pjesë Kryetari i Bashkisë, z. Gledian Llatja, Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore z. Ermir Çela dhe z. Qemal Biçaku. Në këtë takim u diskutua për rëndësinë që ka bashkimi rreth vlerave e qëllimeve të përbashkëta për një kontinent e botë më të mirë.

Të rinjve të Këshillit Rinor ju prezantua historia e familjes Biçaku në Elbasan, që gjatë Luftës së Dytë Botërore u bë një strehë e sigurtë për 26 hebrenj në Elbasan. Traditë që u trashëgua dhe ditët e sotme, ku Elbasani

u bë i pari qytet që hapi dyert dhe mikpritit sportistët ukrainas.

Ndërsa e vuri theksin tek Java Evropiane, Llatja pohoi se "rrugëtimi ynë drejt familjes së madhe evropiane kalon gjithmonë nga gjenerata më e re. Çdonjëri nga ne e gjen veten në Evropë. Jemi në kohë të vështira, edhe pse gati pas 100 vitesh kemi një luftë tjetër në Evropë, është një situatë jo e këndshme për ne, për Evropën, për politikën që ajo ka". Llatja tha se, nëse ne kthejmë kokën pas në Luftën e Dytë Botërore, Shqipëria ishte krah aleatëve, kundër luftës, pro shteteve demokratike.

"Ne nuk duhet të harrojmë edhe holokaustin që ka ndodhur në Luftën e Dytë Botërore, prandaj duhet të jemi të fortë, t'i themi njëzëri jo luftës. Pasi ju jeni rinia, brezi më afër Evropës. Historia e Familjes Biçaku në Elbasan është shembulli më i prekshëm se si ne shqiptarët gjithmonë jemi rreshtuar në anën e së drejtës dhe historia jonë dëshmon se jemi faktor i bashkëpunimit e prosperitetit rajonal", theksoi Llatja. Në fund të rinjve i janë shpërndarë edhe çertifikata vlerësimi me motivacionin "për pjesëmarrjen në aktivitetet e Javës së Evropës 2022".



Ne nuk duhet të harrojmë edhe holokaustin që ka ndodhur në Luftën e Dytë Botërore, prandaj duhet të jemi të fortë, t'i themi njëzëri jo luftës



17. TURIZMI, SA NDIKON NË MJEDIS



Orjela Nazarko

Turizmi është praktika, veprimi i marrë nga ata që udhëtojnë apo vizitojnë vende me qëllim zbavitjeje, njohurish dhe mësimi. Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Turizmit, turist quhet gjithkush që udhëton në vende të ndryshme nga ai në të cilin ka rezidencën aktuale, jashtë ambientit të përditshëm personal, për një periudhë prej minimumi një natë por jo më gjatë se sa një vit dhe qëllimi i tij i zakonshëm të mos jetë asnjë lloj veprimtarie nga e cila të përfitojë ekonomikisht. Përpos anëve pozitive që sjell në ekonomi zhvillimi i turizmit, kohët e fundit kemi vënë re se ky sektor është shoqëruar me ndotje galopante të mjedisit, e cila po ndikon në ngrohjen globale.

Sot po përballemi me një fenomen të etiketuar hiperturizëm, pra me një rritje të vazhdueshme të dendurisë së turistëve në mbarë botën, e sidomos në vendet europiane. Lëvizja e lirë e popullsisë nga njëri vend në tjetrin mundësohet nga transporti ajror, detar e tokësor, të cilët janë kthyer në rrezikun dhe

ndotësin parësor të planetit tonë. Ndikimet negative mjedisore të turizmit ndodhin kur niveli i përdorimit të vizitorëve tejkalon kapacitetin e mjedisit për të mbështetur atë përdorim.

Turizmi i pakontrolluar konvencional paraqet kërcënim potencial për shumë zona natyrore në mbarë botën. Pasoja kryesore negative e hiperturizmit është zgjerimi i gjurmëve të karbonit në atmosferë. Turizmi përfaqëson 60% të trafikut ajror, prandaj është një burim kryesor i emetimeve të GHG. Ndërsa në mënyrë të përgjithësuar, vetëm turizmi lëshon 5% të gazeve serrë, duke u bërë shkaktari i drejtpërdrejtë i ngrohjes globale. Deri në vitin 2050, nëse ritmi i rritjes vazhdon, emetimet e gazeve serrë do të rriten me 131% dhe konsumi i energjisë do të rritet me më shumë se 150%, veçanërisht për shkak të transportit ajror. Pakësimi i karbonit mund të bëhet përmes vendosjes së filtrave tek automietet përkatëse dhe krijimi i pajisjeve më ekologjike, për mbarëvajtjen e frymëmarrjes planetare.

Nga ana tjetër, turizmi ndikon negativisht edhe në biodiversitet, çuar në humbjen e tij dhe shkatërrimin e biomasës. Ndërsa numri i turistëve rritet, duhet të ofrohen më shumë përvoja të reja, edhe nëse ato çënojnë hapësirat më parë të pacënuara. Llojet shqetësohen dhe habitatet e tyre shkatërrohen nga kalimi i turistëve, por edhe nga ndërtimi i objekteve të reja të banimit dhe akomodimit. Rrjedhojë fatale e saj është edhe shkatërrimi i ekosistemeve. Shkëmbinjtë koralorë po vuajnë shumë nga rritja e turizmit. Për shembull, një plazh tajlandez, Maya Bay, duhej të mbyllej për turistët për të lejuar ekosistemin të mbijetojë. Vende të tjera shkatërrohen nga derdhja e ujërave të zeza në det, betoni, shpyllëzimi etj.

Për të mos u thelluar shumë për vendet e tjera, le ta kthejmë vëmendjen tek vendi ynë. Turizmi bregdetar fokusohet në nocionin "plazh dhe diell" dhe njezh fokus të konsiderueshëm nga shteti dhe turistët vendas, por kryesisht ata të huaj.

Destinacionet kryesore bregdetare janë Velipoja, Shëngjini, Durrësi (Deti Adriatik), Vlora, Himara, Saranda, Ksamili (Deti Jon), të cilat janë vërtet një mrekulli e nënës natyrë. Por fatkeqësisht, qenia njerëzore mbart në vetvete edhe peshën e fajit si pasojë e mosndërgjegjësimit dhe të mos qenit rigoroz në jetën e saj. Në plazhin e Durrësit, si pasojë e derdhjes së naftës pa kontroll në det, popullatës së peshqve po i vjen fundi. Kështu, zinxhiri ushqimor po e humb kuptimin e saj të mirëfilltë me shkatërrimin e halkës së dytë, asaj të konsumatorit të parë. Uji, që është kaq i çmuar dhe jetik për ne, po ndotet nga dora shkatërrimtare njerëzore. Gjithashtu, euforia e tejskajshme për zhvillim ekonomik ka bërë që bizneset private të ndërtojnë pa kriter buzë detit vila e hotele luksove, të cilat kanë sjellë betonizim e shkatërrim të mjedisit.

Në përgjithësi, industria e turizmit i shfrytëzon burimet ujore edhe për pishina, hotele, kurse golfi dhe përdorim personal të turistëve. Konsumi i tepërt mund të sjellë një mungesë dhe degradim të furnizimit të ndërmarrjeve me ujë, si edhe në një gjenerim më të madh të ujërave të zeza. Në rajonet më të thata, siç është Mesdheu, çështja e mungesës së ujit është një shqetësim i veçantë. Për shkak të klimës së nxehtë dhe tendencës së turistëve për të konsumuar më shumë ujë me pushime sesa në shtëpi, sasia e përdorur mund të arrijë në 440 litra në ditë. Kjo është pothuajse dyfishi i asaj që përdorin njerëzit në një qytet mesatar spanjoll. Vitet e fundit, turizmi i golfit është rritur në popullaritet dhe numri i fushave të golfit është rritur me shpejtësi. Fushat e golfit kërkojnë një sasi të madhe uji çdo ditë, gjë që mund të çojë në mungesë uji. Për më tepër, klubet e golfit vendosen gjithnjë

e më shumë në/afër zonave të mbrojtura ose zonave me burime të kufizuara, duke komplikuar ndikimet e tyre. Një fushë golfi mesatare në një vend tropikal si Tajlanda ka nevojë për 1500 kg plehra kimike, pesticide dhe herbicide në vit dhe përdor aq ujë sa 60.000 fshatarë ruralë. Ja çfarë degradimi po pëson planeti i vetëm ku ekziston uji në shekullin XXI, sepse pikërisht ky element po keqpërdoret. Çfarë paradoksi!

Nga ana tjetër, data 22 Prill na zgjoi me një lajm pozitiv dhe të këndshëm për veshët tanë. Një nismë vullnetare u iniciua nga emigrantët shqiptarë për pastrimin e liqenit të Shkodrës. Shqipëria është një thesar fshehur i Europës- shprehet një amerikane, e cila e shihte vendin tonë si një mundësi të artë për promovim.

Ajo ç'ka rinia ka në dorë të bëjë, është të kontribuojë maksimalisht në çlirimin gradual të planetit nga këto kthetra mizorie ndotëse, me ndërmarrjen e politikave të ndryshme për pastrim e sensibilizim.

Natyra është hapësira ku ne jemi të lirë të marrim frymë. Me shkatërrimin e saj, ne kemi lënë në harresë një të ardhme të ndritur, sidomos të rinisë. Ashtu siç ka thënë edhe Njutoni, në natyrë nuk ka veprim, por bashkëveprim. Si një fanatike e mbrojtjes së mjedisit, më lind natyrshëm një pyetje: "Ju që nuk doni natyrën, si mund të doni njëri-tjetrin?"

18. DOSTOJEVSKI DHE ÇËSHTJA E ZOTIT

"Nuk ka joshje më të madhe për njeriun se liria e ndërgjegjes, por nuk ka dhe asgjë më rraskapitëse për të."

Duke krijuar romanin "Idioti", Dostojevski shkroi një letër drejtuar A. Maikov ku pohoi se shpresonte që në të ardhmen e afërt mund ta përqendronte punën e tij rreth një çështjeje "me të cilën jam torturuar me vetëdije ose pa vetëdije gjatë gjithë jetës



Mariza Ranxha

sime - domethënë ekzistenca e Zotit". Lufta personale e Dostojevskit me çështjen e besimit dhe ndjenja e dyshimit, manifestohet tek personazhet që ai krijon. Pjesa më e madhe e veprës së tij është shkruar brenda kornizës së doktrinës së krishterë, duke vënë përballë besimtarë e jobesimtarë dhe duke theksuar të mirën dhe të drejtën që vjen me zotërimin e besimit. Por Dostojevski përshkruan në mënyrë të kulluar edhe vuajtjen mendore e pyetjen e natyrshme që vjen me të "të vërtetën" e Jezu Krishtit. Nikollai Berdiaev, në lidhje me Dostojevskin, theksoi, se "[Dostojevski] nuk donte të zgjidhte problemin hyjnor siç bën pagani, por problemin e njerëzimit, që është problem shpirtëror, si një i krishter".

Edhe pse një pjesë e madhe e edukimit të Dostojevskit duket që ka ndodhur në një fole të krishterë, ai ka qenë gjithashtu i ekspozuar ndaj cilësive të ashpra që zotëronte njeriu. Babai i tij ishte, edhe pse i nderuar, gjithnjë i dehur e agresiv, madje u vra nga bujkrobërit e tij për shkak të trajtimit çnjerëzor. Kjo sferë më e ashpër e botës iu rishfaq edhe më vonë. Dostojevski u përfshi në një grup të njohur si "socialistët utopikë rusë", i ndikuar

nga Belinski. Partneriteti i krijuar nga të dy me sa duket tronditi besimin e Dostojevskit, pasi mentori i tij i nderuar zbuloi se "si një socialist, ai duhej të shkatërronte në radhë të parë krishterimin." Por ndërsa ishte në burg (ku i vetmi libër i lejuar ishte Bibla), duket se ai filloi të rikonsideronte veten besimtar. Fakti që ishte në gjendje të kultivonte një besim brenda një mjedisi kaq armiqësor tregon forcën e bindjes së tij.

Për Dostojevskin atëherë, problemi nuk ishte njohja e së vërtetës, por eliminimi i dyshimit të lidhur me Zotin. Burimi kryesor i dyshimit që mundonte Dostojevskin ishte lufta e tij për të pajtuar vuajtjet e dukshme në botë dhe nocionin e një Zoti të mirë. Ky konflikt shprehet qartë tek Ivan Karamazov "Nuk është Zoti Ai që nuk pranoj, kuptoje këtë Aliosha. Unë nuk pranoj botën, Ai e krijoi këtë botë, dhe nuk mund të pajtohem me këtë. [...] Unë jo se nuk e pranoj Zotin, Aliosha, vetëm se biletën ia kthej më gjithë respektin". "Vëllezërit Karamazov", romani në të cilin Dostojevski trajton në mënyrë më të qartë çështjen e Zotit, ishte planifikuar në një mënyrë që të vinte përballë besimin dhe ateizmin. Besimi identifikohet kryesisht si "dashurinë aktive" që Aliosha shfaqti ndaj vëllezërve të tij, por në thelb, murgu Sozima, shërbeu si një arketip, përmes të cilit autori donte të bindte njerëzit se ekzistonte një krishterim ideal i pastër, dhe se krishterimi është streha e vetme e tokës ruse nga të gjitha të këqijat e saj.

Besimi i shfaqur kryesisht tek Aliosha kundërshtohet nga intelekti i Ivanit. Megjithatë, siç shpjegon Mokulski, mbrojtja që i bën autori Ivanit ndaj ateizmit "qëndron në atë që ai heq dorë nga Zoti për shkak të dashurisë për njerëzimin, del kundër Krijuesit në rolin e mbrojtësit të të gjithë të vuajturve." Ivan përpiket të fusë në "kurth" Alioshën në dy pika, vuajtja e të pafajshmëve dhe konceptimi i lirisë së zgjedhjes. (në thelb vullneti i lirë)

Vuajtja e fëmijëve është e paarsyeshme dhe e padrejtë për Ivanin. Në monologun e tij Ivani tregon shembuj të tmerrshëm të torturave të fëmijëve, duke i kërkuar Alioshës të pajtojë një abuzim të tillë me Perëndinë e tij të dashur. Brenda këtij diskutimi Dostojevski

shkruan atë që është shpallur si puna e tij më e thellë, "poemën" e Ivanit në lidhje me Inkuizitorin e Madh. Ivan fajëson Krishtin për rënien dhe mosbesimin e njeriut në një rrugë të habitshme arsyetimi:

"Sepse fshehtësi të qenies njeri nuk përbën jetesa dhe mbijetesa, por përbën motivimi i asaj, pse duhet jetuar dhe mbijetuar. Pa pasur një përfytyrim të saktë për atë, se përse duhet jetuar dhe mbijetuar, njeriu nuk pranon të jetojë e të mbijetojë, shkon deri në vetasgjësim, e parapëlqen më tepër se jetën e pakuptimtë. [...] Në vend që ta përvetësoje lirinë e njerëzve, Ti ua fale të zgjeruar! Mos vallë, e ke harruar që prehja, por edhe vdekja, për njeriun është më e shtrenjtë se zgjedhja e lirë në njohjen e të mirës dhe të keqes?"

Berdiaev, në një shpjegim të përqendrimit intensiv të Dostojevskit mbi lirinë, thekson se, "për të, justifikimi i Zotit dhe i njeriut duhet të kërkohej në liri..." Për të përmbledhur atë çka Ivani do të thotë në poemën e tij, Brediaevi interpreton: "Bota është plot me ligësi dhe koprraci pikërisht sepse bazohet në liri megjithatë ajo liri përbën të gjithë dinjitetin e njeriut në botën e tij." Dostojevski në fund bën dallimin midis dashurisë së etur që nuk bën asgjë dhe nënshtrrohet, dhe dashurisë aktive (ajo e poseduar nga Aljosa dhe murgu i vjetër) që ka fuqinë për të shpëtuar.

Ndërsa Dostojevski shqyrton dyshimet e tij fetare, duke e përcjellë luftën e tij të brendshme nëpërmjet zërave të personazheve të tij, është e qartë se vendosmëria e tij përfundimtare qëndron në një bindje të plotë për praninë e Zotit. Duke vënë në dukje situatën që ai i lë personazhet e tij në përfundimin e veprave të tij, është e qartë se personazhet "të mirë" ose të pëlqyeshëm janë në linjë me Zotin dhe personalitetet "e liga" rebelohen kundër të Plotfuqishmit. "Vëllezërit Karamazov" përfundon me Alioshan dhe Miten si besimtarë, ndaj të cilëve ne ndjejmë dhembshuri dhe dashuri, ndërsa Smerdiakovi dinak dhe i keq kryen vetëvrasje, akti më i fortë i rebelimit kundër Zotit siç lë të nënkutpohet autori me anë të Ivanit. Dostojevski në mënyrë të qartë i bashkon heronjtë e tij me një besim të fortë në Zot dhe keqbërësit e tij me ateizmin (dhe socializmin), duke sugjeruar përfundimin e tyre.

Megjithatë verdikti i tij është i padiskutueshëm-edhe pse si njerëz ne mund të përpiqemi të racionalizojmë Zotin, si besimtarë do të pranojmë se injoranca jonë është e qëllimshme. Në disa pika, debatet e shkëlqyera logjike që shkruan Dostojevski duket se sugjerojnë se autori po humbet bindjen e tij. Megjithatë, veprimet dhe fuqia e asaj që ai quante dashuri aktive hedhin poshtë çdo dyshim në lidhje me themelin e bindjeve të autorit. Ne, si lexues vendosemi në pozicionin e afrimit të besimit me logjikën dhe arsyetimit.

Në planin personal vepra më la të konfliktuar. Mendoj se kur arrin një zhvillim të caktuar mendor (normalisht në ndikim të ambientit ku jeton) vjen koha që do dyshosh tek autoriteti i Zotit. Para leximit të veprës do e konsideroja veten ateiste, ekzistenca e Tij më dukej komplet irracionale dhe si një mekanizëm i kontrollit në mase, por nga kapitulli në kapitull mëson se në të vërtetë mund të mos jetë ashtu. Megjithëse jam rritur në një ambjent të krishterë/Ortodoks, njëlloj si autori, kurrë nuk e kisha parë fenë dhe besimin si burim të një prehjeje kaq të madhe.

Nganjëhere kur flet me "besimtarë" të duken si të bezdisur, sikur çdo gjë që thonë është dogmë dhe sikur qëllimi kryesor i bisedës është të të hipnotizojnë, ama kuptova se qenka e vërtetë kjo teoria e Dostojevskit se paska njerëz që besojnë në Zot, dhe besimtarë që besojnë në Të. Aliosha dhe Sozima janë personazhe kaq të mirë, të paqtë, të drejtë dhe dallohet se këtë qetësi ua jep besimi i pafund në Zot dhe të mirën e tij, por unë i ngjasoj më tepër Ivanit vetëshkatërrues. Mënyra se si mendon, shprehet dhe gjykon Ivani janë njëlloj me të miat, andaj e kam të vështirë të krijoj një antitezë për tezën e tij, e cila për hirë të së vërtetës ishte integruar thellë në mendjen time edhe para leximit të veprës. Njëlloj si ai jam e aftë të dua njerëzimin dhe "të rebelohem" kundër Krijuesit. është afër mendjes se nëse Zot vërtetë ka, atëherë Ai ka krijuar çdo të keqe e si pasojë Ai s'mund të jetë kurrësesi i mire apo i dashur. Dyshimi i Ivanit s'është fare irracionale, madje në pamje të parë të duket më i logjikshëm se kundërvënia e Alioshës.

Ajo çka unë nxjerr nga Dostojevski dhe leximi i kësaj kryevepre ndoshta është

shumë më modeste në krahasim me atë që ai donte, ama në ca pika edhe pse i shoh si të argumentuara mirë nuk pranoj të gdhendem. E vërteta hyjnore nuk po më pret mua të gjendet, prandaj nuk më interesojnë “provat” e ekzistencës apo jo të Zotit. Ajo çka shoh me interes është aspekti moral dhe social i çështjes dhe këtu njëlloj si Ivani them se nuk është se s’besoj në Zot, por nuk mund ta pranoj botën e tij, e cila buron o nga vet ligësia jonë ose nga ajo e Zotit. Cilido të jetë

burimi, jam e mendimit se ajo që ne duhet të praktikojmë është dashuria aktive e protagonistit. Të duash dhe të falësh çdo njeri duket pak koncept utopik në botëkuptimin tonë, por në një fare mënyre është e vetmja rrugë që të çon drejt paqes shpirtërore dhe asaj të përgjithshme. Nuk dua të argumentoj se besimi është rruga e vetme drejt lumturisë, përmbushjes, lirisë, ama situata në të cilën gjendet bota sot e bën qëndrimin e besimarëve të kulluar aq tërheqës sa më s’ka.

19. “VERA E NJËQIND VJETËVE VETMI”



Alem Bedhija

Eksperiencia e vërtetë “alla letrare” e kësaj vere për mua, që fare mirë mund të them se konkretizon shijen e vërtetë të verës tek unë, filloi kur më ra ky libër në dorë. Çuditërisht, autorët latino-amerikanë kanë qenë të vendosur gjithmonë në majë të bibliotekës sime familjare, derisa e mora vetë në dorë rregullimin e saj. Tani e kuptoj fare mirë pse një prind i mirëinformuar, nuk do

të donte që fëmijës së vet t’i binte në dorë para kohe “Njëqind vjet vetmi”. Në ka fjalë të ripërsëritura në këtë vepër ato janë kafshëri mbresëlënëse, shkapërthim, konkubinë, marrëdhënie etj. Pa dyshim, pa mohuar atmosferën e një Kazanove karaibesh që të jep nocioni i këtyre fjalëve dhe njohuria se autori vjen nga Kolumbia, mendoj se e lexova në kohën e duhur. Përtej peshës që lind nga emri, bota e realizmit magjik dhe shpërthimeve të paimagjinueshme të skutave më pjellore të Marquez-it më ka ngritur peshë, ma ka sjellë mendjen vërdallë 180°, më ka lënë pa gjumë në net të caktuara dhe më ka faturuar një ndjesi habie të lartë, sepse ndjesia se realiteti imagjinari i romanit që po lexoni është ai i një jete që ju e njihni është frikshmërisht i paimagjinueshëm.

Marquez është frymëzuar nga fshati i tij i lindjes dhe fëmijëria e mbushur plot figura grash të fuqishme për këtë vepër, që në rrethet e thashethemnajave të lexuesve dhe më pas në rrethin e kritikëve letrarë thuhet se është vepra kryesore që i siguroi atij Nobelit e 1982-it. Vepra ndërtohet mbi historinë e shtatë brezëve të familjes legjendare Buendia-Uguaran, Kjo vepër gëlon nga personazhe të fuqishëm, që në thelb përfaqësojnë karaktere njerëzore dramatike, të patundura, besnike, të zgjuara, të pagdhendura, stoike, mallëngjyese, të urryera, epushore, të rrezikshme. Imagjinoni pak një familje të drejtuar nga një grua mbi 100 vjeç, në radhët e së cilës gjenden ndër kohë një burrë i marrë, një virgjëreshë e përbetuar, një

bijë e birësuar që dashurohet me të vëllanë e humbur prej vitesh, një nuse pa asnjë të përbashkët me familjen e të shoqit, një vashë me bukuri të rrallë por me një përjasje boshe për jetën, një kolonel i rritur në trupin e një djaloshi vetmitar. Gërshetohet këto me ciganë magjistarë, elementë fantastikë ngritjesh në qiell, fluturash të verdhë që dalin nga hiçi, aromash ekzotike, fantazmash të së shkuarës dhe dhomave ku koha ka ndaluar për të mos përparuar. Në dorë e në mendje do të keni veprën më përfaqësuese të realizmit magjik, e cila kur u botua më 1967-ën, i ridha identitetin kulturor një kontinenti dhe i dhuroi botës atë që shume e kanë quajtur "Don Kishoti" i kohës sonë.

Teksa përpiqem të mendoj për një arsye të mirëfilltë pse kjo vepër më bëri kaq shumë për vete, arrij në përfundimin se së pari, ajo është si asnjë tjetër që do të më jepet mundësia të lexoj dhe së dyti, kjo vepër tingëllon shumë bukur në gjuhën tonë. Kjo sagë e përbindshme nuk mund të konturohet vetëm nën shpjegimin e një pjelle imagjinare të autorit. Unë mendoj se ajo është gjithçka tjetër veç kësaj. Kjo vepër është shkruar për të dhënë një mesazh. Ajo është dëshmia e Marquez-it për ndryshime kolosale në shoqërinë e tij. Unë them se autori ka zgjedhur të përfshijë elementë tradicionalë nga kultura e vet jo vetëm për t'i dhënë një pikë në hartë veprës, por sepse historia e vendit që ajo i përket ka nisur nga njerëz që mishërohen në personazhet e saj, nga besime dhe zakone të njëjta me ato të fshatit dhe banorëve të tij. Ky libër është i stërm bushur me elementë të tillë, por asnjë nuk e përcjell më së miri esencën e vërtetë të tij sesa faqja e fundit. Në të thuhet se breznitë e dënuara me njëqind vjet vetmi nuk kishin një mundësi të dytë mbi tokë.

Këtu qëndron dhe e bukura e veprës. Askush nuk i dënoi këto brezni me njëqind vjet vetmi, ato dënuan veten. Duke nisur që nga origjina e familjes, duke vazhduar me gabimet e përsëritura, zgjedhjet e gabuara dhe shumë të tjera të mohuara. Aureliano Babilonia, i fundit Buendiave është fryma e fundit e gjallë që përjeton shfarosjen e fshatit dhe gjithë trashëgimisë njëqindvjeçare. Pergamenët që ai kërkon të deshifrojë, brenda dhomës ku koha nuk lëviz, janë mënyra e autorit

për të thënë se fati i kësaj familjeje është i paracaktuar. Jeta në të lulëzon ndër vite, gjen mënyra të ndryshme për të shtrënguar fort çfarë është e zakonshme dhe kriset keqazi sa herë diçka jashtë të zakonshmes bëhet pjesë e saj.

Në vetvete, kjo vepër fillon si duhet: me dëshirën për të gjetur rrugë të reja e për ta shpërndarë farën e jetës edhe më gjerë, por ajo na tregon se yjet, fluturat apo dhe vetë qiejt, nuk kanë se ç't'i japin më shumë sesa kohë shteruese zigzageve të paqëndrueshmërisë. Thënë thjeshtë, historia e Makondos dhe jetëgjatësisë së tij, është profecia e autorit për gjithë botën latino-amerikane, një profeci e fabrikuar me qëllim për të mos u përmbushur, por për t'i vënë njerëzit në lëvizje, për t'i trembur nga fati i njëqind vjetëve vetmi, për t'i zgjuar.

"Njëqind vjet vetmi" nuk të zgjon, por të fal një jetë tjetër.

20. SHENJTI QË I VURI EMRIN NJË FSHATI



Në komunën Bradashesh, rreth 4 kilometra larg Elbasanit, ndodhet një fshat me emrin Shijon, ku ndodhet edhe një manastir, i cili shihet teksa zbret të tatëpjetën e Qafë-Krrabës. Historia e vendbanimit në fshatin Shijon daton rreth viteve 1010 – 1020, që nga Mali i Zi, ku prifti Shën Joan Vladimiri do të predikonte ritet e fesë ortodokse e më pas ky fshat do të mbante emrin e tij. I përbërë nga 200 familje, të tërë të fesë ortodokse, banorët e këtij fshati e quajnë veten me fat që mbajnë emrin e shenjtit Shën Joan Vladimiri.

Gjatë luftës së Dytë Botërore manastiri u dogj dhe ishin banorët e fshatit Shijon ata që e rindërtuan sërisht.

Shën Joan Vladimiri ka lindur në fshatin Vladimir të Krajës në Malin e Zi. Ka jetuar

në shekullin e XI. Oborrit e tij e ka pasur në Krajë ku ndodhet edhe një kryq druri i madh i këtij shenjt dhe ku bëhet panairi madhështor më 4 qershor, në të njëjtën kohë kur bëhet edhe në manastirin afër Elbasanit, në Shijon. Ati i tij Neemani, ishte mbret i Ilirisë dhe veç Ilirisë sundonte edhe Malin e Zi, Dalmacinë, Bosnjën edhe disa krahina të Greqisë pranë Prevezës.

Pas vdekjes së të atit mori sundimin ai vetë. Duke u djegur nga dëshira për të bashkuar të gjithë shtetasit e tij me Kishën e Shenjtë, dërgoi në të gjithë mbretërinë predikues për të hapur besimin e vërtetë dhe për të kthyer jobesimtarët në të krishterë. Më pas, ai themeloi manastire, kisha dhe institucione bamirësie.

Ka disa legjenda mbi fatin tragjik të këtij

shenjti dhe të gjitha e lidhin atë me Carin bullgar Samuelin dhe të bijën e tij Kozarën. Në një pankartë që shpërndahet në këtë ditë shpjegohet edhe në detaje historia e shenjtit dhe se si mbërriti ai në fshatin Shijon.

“Në fillim të shekullit të X-të kur Perandoria Bullgare arriti kulmin e zgjerimit të saj, Samueli pushtoi edhe Durrësin dhe nisi të shtrinte zotërimet e tij më në veri, rreth Shkodrës.

Pikërisht në këtë kohë duket se ka lindur legjenda e Gjon Vladimirit, i cili më vonë do të shpallej “Shenjt”. Shën Gjon Vladimiri do të binte rob i bullgarëve dhe burgosej diku në një vend afër Ohrit apo Prespës. Pikërisht këtu është njohur me Kozaren e duke qenë se Samueli e kishte dobësi të bijën, vendos ta martojë me Gjon Vladimirin. Por, dy vëllezërit e Kozarës të etur për pushtet e shihnin me zili pajën që përfitoi i kunati, pasi Gjon Vladimiri befasi e kishte parë veten “Zot” të një pjese të mirë të Shqipërisë së Mesme. Nuk dihet nëse ishte vetë Kozara që e nxiti vrasjen e të shoqit apo vëllezërit e saj, por sido që të jetë, pas një ftese të zakonshme për një gosti tinëzare, Gjon Vladimiri iu pre koka. Sipas legjendës, thuhet se shpata nuk i bindej vrasësve dhe atëherë Gjon Vladimiri i ka dhënë shpatën e vet. Legjenda thotë se Gjon Vladimiri udhëtoi me kalë me kokën e prerë në prëhër deri në vendlindjen e tij në anë të Liqenit të Shkodrës. Por, ka më shumë gjasa që Kozara e cila përfundoi murgeshë, ta ketë marrë trupin e të shoqit e ta ketë çuar në një kishë të vjetër në krahinën e Krajës.

Eshtrat e Gjon Vladimirit u ruajtën deri në vitin 1215 në kishën “E papërlyera e Krajës” në Malin e Zi të sotëm, e në këtë vit despoti Mihal Komneni i transferoi në Durrës ku mbetën deri në vitin 1381, kur Karl Topia, princi katolik shqiptar, rindërtoi një kishë të vogël rreth së cilës u ngrit më pas manastiri i sotëm. Sipas legjendës, u zgjodh ky vend pasi Shën Gjon Vladimiri i kishte bërë përshtypje të madhe një shqiptarje e bardhë që fluturonte mbi kryet e tij. Ajo mbante në sqep një kryq të drunjtë, shenjti e ka ndjekur shqiptarjen gjatë. Pikërisht në vendin ku është manastiri sot shqiptarja e bardhë lëshoi kryqin. Në këtë vend shenjti ndërtoi një kishë të vogël, pikërisht atje ku lutej.

Karl Topia solli në kishën e ndërtuar rishtas prej tij eshtrat e shenjtit. Kur mbërriti në atë vend trupi i tij u dëgjua fjalët: “Në duart e tua, o Zot po jap shpirtin tim” Atëherë u dëgjua psalme prej qiellit dhe gjithë vendi u mbush me erë të këndshme. Që në atë moment në këtë manastir u bënë shumë mrekullira me të sëmurët që preknin lipsanin e tij të shenjtë, me besim e shpresë.

Rëndësia e Manastirit është bashkimi i njerëzve për të marrë mirësi dhe ngrohtësi nga shënjtori, që në histori është quajtur Shenjt i Dritës.

4 qershori, dita që u vra Shën Gjon Vladimiri, është shpallur festë e komunës Bradashesh.

E celebruar si “Dita e Mirëkuptimit dhe e Harmonisë”, me qindra besimtarë të feve të ndryshme jo vetëm nga rrethi i Elbasanit, por edhe qytete të tjera të vendit, marrin pjesë në pelegrinazhin e organizuar çdo vit në manastirin e Shën Joan Vladimirit.

Dita e 4 qershorit, e cilësuar si festë pagane për banorët e fshatit, festohet çdo vit ku besimtarët nderojnë figurën e Shën Joan Vladimirit.



ADRESA: BASHKIA ELBASAN, RR. "Q.STAFA"
TEL: +355 54 400152
EMAIL: BASHKIAELBASAN@ELBASANI.GOV.AL
WEB: WWW.ELBASANI.GOV.AL
FACEBOOK: @ELBASANBASHKIA

BULETIN

BASHKIA ELBASAN

